



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.02. 2010

V E N D I M
Nr.1175 datë 19. 02. 2010

Për

“Miratimin për këshillim publik të Rregullores “Për dhënien e licensës “Autoritet i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 3. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 4. Z. Ibsen | Elezi | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës 19.02. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, me objekt:

“Miratimin për këshillim publik të Rregullores “Për dhënien e licensës “Autoritet i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC””,

mori në shqyrtim materialet shkresore të paraqitura nga Grupi i Punës të përbëra nga:

- Projektregullore “ Për dhënien e licensës “Autoritet i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC” (**Projektakti**);
- Relacioni shpjegues mbi projektaktin (**Relacioni**);
- Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485 (**Projektvendimi**).

BAZA LIGJORE:

1. Shkronjat p) dhe r) të nenit 8 dhe neni 110 të ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Seksioni IV i VKM nr. 370, datë 5.06. 2003 “Për miratimin e strategjisë “ Për shërbimin e radiondërlidhjes detare në Republikën e Shqipërisë” (**VKM nr. 370**);
4. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E H E T se :

1. Projektakti është hartuar nga Grupi i Punës në zbatim të Urdhërit Nr. 515, datë 17. 12. 2009 të Kryetarit të KD
2. Projektakti është nxjerrë në zbatim të VKM Nr. 370 dhe në mbështetje të shkronjës p) dhe r) të nenit 8 të këtij ligji.
3. Dokumentacioni i paraqitur nga pikpamja formale procedurale është në përputhje me përcaktimet e parashikuara në nenin 10/1 të Rregullorës së Brendshme dhe ligjin nr. 8485.
4. Përmbajtja e projektaktit është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9918, me rregulloret në fuqi të ITU-së, Rregulloret Ndërkombëtare të Telekomunikacioneve (Melburn 1988), rekomandimet në fuqi të ITU-T, si dhe VKM Nr. 370.
5. Projektregullorja është konsultuar me konsulentin “Development Dynamics” L.td. në kuadër të projektit “EBRD/EU Communications Regulatory Development Project”.

ATEHERE:

Për sa më sipër, duke patur parasysh se projektakti përmbush kërkesat ligjore të përcaktuara në bazën ligjore referuese, KD i AKEP bazuar në pikën 1 të nenin 115 të ligjit nr. 9918 dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

V E N D O S I :

1. Të miratojë Projektregulloren për këshillim publik “Për dhënien e licensës “Autoritet i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC””, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi dhe nxjerrjen e saj me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, për këshillim publik sipas nenit 110 të ligjit nr. 9918.
2. Afati i këshillimit publik është deri më datë 19. 03. 2010.
3. Ngarkohet Grupi i punës sipas Urdhërit Nr. 515, datë 17. 12. 2009 për ndjekjen e procesit të këshillit publik sipas nenit 110 të ligjit nr. 9918 dhe paraqitjen e materialeve shkresore pas mbylljes së këshillimit publik, për miratim përfundimtar në mbledhjen e Këshillit Drejtues.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Piro XHIXHO

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RR E G U L L O R E

**“PER DHENIEN E LICENSES “AUTORITET I LLOGARIVE DETARE”
DHE KODIN AAIC”**

MIRATUAR ME VENDIM TE KESHILLIT DREJTUES TE AKEP Nr.1175, Date 19.02.2010.

Neni 1

1

Qëllimi

Qëllimi i rregullores është normimi juridik i procedurës që zbaton Autoriteti i Komunikimeve Elektronike (**AKEP**) për dhënien e licensës “Autoritet i llogarive detare” (**ALD**) subjekteve të interesuara dhe pajisjen me kodin e identifikimit (**AAIC**).

Neni 2 Objekti

1. Objekti i rregullores përfshin procedurën që zbaton AKEP për dhënien e licensës “Autoritet i llogarive detare” subjekteve të interesuara, pajisjen e tyre me kodin e AAIC, si dhe kushtet që duhet të plotësojnë aplikuesit për t’u pajisur me këtë licensë.
2. Përkufizimi në kuptim të përcaktimit ALD, kodit AAIC etj., fusha e veprimit, përgjegjësitë, raportimi, pagesat, regjistrimi nga AKEP, inspektimi dhe sanksionet, parashikohen në seksionin IV të Vendimit e Këshillit të Ministrave Nr. 370, datë 05.06.2003 “Për miratimin e strategjisë “Për shërbimin e radiondërlidhjes detare në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3 Baza ligjore

1. AKEP, për nxjerrjen e kësaj rregullore mbështetet në gjurmën p) të nenit 8 dhe pikën 2 të nenit 138 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje bazohen në:
 - a) Seksionin IV të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 370, datë 05.06.2003 “Për shërbimin e Radiondërlidhjes detare në Republikën e Shqipërisë” (**VKM nr. 370**);
 - b) Shtojcën 2 të ITR dhe rekomandimit D.90 të ITU-T.

Neni 4 Parimi i zbatueshëm për dhënien e licensës

AKEP, për trajtimin e kërkesave për licensë ALD dhe kodin AAIC, zbaton parimin “kush vjen i pari, shërbehet i pari”. Kjo nënkupton që subjektet që përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, pajisen me licensë bazuar në momentin e regjistrimit të kërkesës së tyre në AKEP.

Neni 5 Kushtet për pajisjen me licensë

Për t’u pajisur me licensë ALD dhe kodin AAIC, subjektet e interesuara duhet të plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë subjekte të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (**QKR**) sipas ligjit nr. 9723, datë 03. 05. 2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
2. Të disponojnë burime të mjaftueshme financiare dhe kapacitete njerëzore me njohuri dhe aftësi të nevojshme profesionale, për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Neni 6

Dokumentacioni

Subjektet e interesuara për t'u pajisur me ALD dhe AAIC paraqesin në AKEP dokumentacionin e poshtëshënuar:

1. Kërkesën me shkrim të subjektit për licensë ALD dhe kodin AAIC, në të cilën të jenë vendosur dhe të dhënat mbi personin e kontaktit, adresë e-mail, nr. tel./faksi.
2. Ekstrakt historik të regjistrimit tregtar dhe dëshmi penaliteti të subjektit të lëshuar nga QKR. jo më herët se 30 (tridhjetë) ditë përpara regjistrimit të kërkesës në AKEP.
3. Kopje të NIPT ose kodit fiskal në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Deklaratën me shkrim të subjektit që:
 - disponon burimet financiare të mjaftueshme për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë;
 - disponon kapacitetet njerëzore me njohuri të mjaftueshme profesionale për ushtrimin e këtij aktiviteti;
 - merr përsipër detyrimet dhe përgjegjësitë ligjore që burojnë nga Seksioni IV i VKM nr. 370;
 - do të zbatojë rregulloret dhe rekomandimet e ITU-së, Rregulloret Ndërkombëtare të Telekomunikacioneve (ITR) si dhe rregullat e nxjerra nga AKEP për këtë veprimtari.

Neni 7

Trajtimi i kërkesës

1. Kërkesa me dokumentacionin bashkëshoqërues dorëzohet në rrugë postare ose dorazi nga subjekti i interesuar, në AKEP.
2. Nëse dokumentacioni shoqërues gjendet në përputhje me nenin 6 të kësaj rregulloreje, kërkesa e paraqitur nga subjekti për t'u pajisur me licensë ALD dhe kodin AAIC trajtohet nga AKEP brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e regjistrimit të saj në regjistrin përkatës të zyrës së protokoll- arkivit të AKEP.
3. Brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, në përfundim të trajtimit të kërkesës së subjektit, nëse aplikuesi çmohet në përmbushje të kushteve të parashikuara në këtë rregullore, AKEP e pajis atë me licensën ALD dhe kodin përkatës AAIC. Licensa nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Drejtues të AKEP-it.
4. Në rast parregullsie të dokumentacionit të paraqitur, brenda 7(shtatë) ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës, aplikuesi njoftohet nga AKEP për parregullsinë/të e konstatuara dhe rregullimin e tyre në një afat sa më të shkurtër të mundshëm por jo më shumë se 30 (ditë) nga data e marrjes së njoftimit.
5. Aplikimet me dokumentacion të fallsifikuar ose në kundërshtim me formën ligjore të parashikuar në momentin e lëshimit të tyre, përbëjnë shkak për refuzimin e kërkesës dhe sipas rastit, kur përbëjnë vepër penale, nga AKEP vepron në përputhje me legjislacionin penal në Republikën e Shqipërisë.
6. AKEP, rregullisht në mënyrë periodike, informon ITU me listen e përditesuar të subjekteve të licensuar ALD dhe kodin përkatës AAIC të tyre.

Neni 8

Licensa ALD, kodi AAIC dhe pagesa

1. AKEP, pajis subjektet e interesuara me licensën ALD dhe kodin AAIC sipas formatit të paraqitur në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje.
2. Afati i vlefshmërisë së licensës ALD dhe kodit AAIC është 3(tre) vjet me të drejtë rinovimi në përputhje me kushtet dhe rregullat në fuqi në momentin e rinovimit të saj. Licensa hyn në fuqi datën e tërheqjes së saj nga subjekti pranë zyrës së protokoll-arkivit të AKEP.

3. **AAIC** për Shqipërinë do të ketë formatin si më poshtë:

ALX₁X₂ - Dy gërmat e para AL identifikjnë Shqipërinë, ku **X₁** dhe **X₂** është çdo numur nga 0 në 9.

Për shembull: **AL01, AL02...AL99**.

3. PAGESA për marrjen e licensës ALD dhe kodit AAIC bëhet nga subjekti në llogarinë bankare të AKEP përpara tërheqjes së dokumentit (Licensës) nga zyra e protokoll-arkivit në AKEP. Niveli i pagesës përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.
4. AKEP publikon listen e subjekteve të licensuara ALD dhe të pajisura me kodin AAIC.

Neni 9 Rregjistrimi i AAIC

AKEP-i regjistron kodin AAIC që u jep subjekteve të licensuara ALD, në regjistrin përkatës dhe i publikon në faqen e tij elektronike www.akep.gov.al

Neni 10 Veprimtaria

Subjekti i pajisur me licensë ALD dhe kodin AAIC:

1. Vepron si ndërmjetës ndërmjet pronarëve të anijeve dhe ofruesve të shërbimit duke lehtësuar grumbullimin dhe shpërndarjen efektive të pagesave për llogari të thirrjeve radiotelefonike dhe teletekste joemergjente të anijeve.
2. Për ushtrimin e veprimtarisë, mbajtjen e përgjegjësisë dhe zbatimin e detyrave të përcaktuara në VKM nr. 370, lidh kontratë biznesi me pronarët e anijeve dhe ofruesit e shërbimit.
3. Informon rregullisht dhe periodikisht AKEP-in me listen e përditësuar të anijeve që u ofrohet shërbim nga ofruesit e shërbimeve sipas VKM 370.
4. Publikon tarifatat që aplikon për ofrimin e shërbimit.
5. Zgjidh mosmarrëveshjet midis pronarëve të anijeve dhe ofruesve të shërbimit, mbi bazën e një rregulloreje të nxjerrë dhe publikuar prej tij, për këtë qëllim.

Neni 11 Dispozita të fundme

1. Rregullorja hyn në fuqi datën e miratimit të saj nga Këshilli Drejtues i AKEP dhe është e detyrueshme për t'u zbatuar.
2. Çdo ndryshim i mundshëm i rregullores do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimet e rekomandimet e ITU, të pranuar nga Republika e Shqipërisë.
3. AKEP, në rast mosmarrëveshje midis të licensuarit ALD dhe pronarëve të anijeve ose ofruesve të shërbimit, nëse palët i drejtohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, i trajton ato në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 120 të ligjit nr. 9918 dhe rregullores "Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve".



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

L I C E N S E

PER USHTRIMIN E VEPRIMTARISE

"AUTORITET I LLOGARIVE DETARE "

DHE PAJISJEN ME

KODIN AAIC - ALX₁X₂

SUBJEKTIT:

" _____ "

Me adresë: _____

Data e hyrjes në fuqi: ____ . ____ . ____

E vlefshme deri më: ____ . ____ . ____

Lëshuar nga AKEP në zbatim të VKM nr. 370, datë 05.06.2003 "Për shërbimin e Radiondërlidhjes detare në Republikën e Shqipërisë" dhe Rregullores "Për dhënien e licensës "Autoritet i llogarive detare" dhe kodin e identifikimit AAIC", miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, Nr. _____, datë ____ . ____ . 2010

K R Y E T A R I

(Firma, vula)